



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DEVOLL
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ prot.

Bilisht, më _____.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Vegla Pune ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Vegla dore-44511000-5;

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,006,905 (një milion e gjashtë mijë e nëntëqind e pesë) lekë pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar , nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Devoll** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit e shtojces (Shtojca 9).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 55, pika 4, “Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”. Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa c), për procedurat nën kufirin e ulët monetar, siç është rasti i kësaj procedure.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM “Për rregullat e prokurimit publik”, e cila parashikon se Autoriteti kontraktor për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojë për një periudhë maksimumi deri në 3 vitet e fundit financiare. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për pervojën e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës **dhe** fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar ne organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasite e mallrave të furnizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar ne organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasite e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.i ndryshuar Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenit 55, pika 4, germa b) në vlerën 20% të fondit limit.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të shërbimit të kërkuar objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë realizuar kontratat e ngjashme, të jetë afër limitit maksimal të lejuar dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të dorëzojë mostra për mallrat si më poshtë:

Nr.	Pershkrimi	Njesia
1	Lopata me bisht	Cope
2	Kazma me bisht	Cope
3	Prerese Ligustrash me bateri	Cope
4	Motorshare benzine 2.8 kW	Cope
5	Korese bari me benzine(me helike, me rota) 2.6 kW	Cope
6	Korese bari me benzine(me filispanje) 2,0 kw	Cope
7	Trapan me bateri	Cope
8	Matrapik	Cope

Mostrat duhet te dorezohen me nje shkrese percjellese ne Bashkine Devoll ,ne zyren e protokoll-arkivit, ne daten dhe oren e hapjes se tenderit. Mos dorezimi i te gjitha mostrave dhe ne afatin e caktuar do te sjelle skualifikimin e operatorit pjesemarres.

Argumentim: Referuar VKM nr 285 dt 19.05.2021 “Per Miratimin e rregullave te prokurimit public” neni 40 pika 6 është përcaktuar se:

Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

Mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

Vendosja e ketij kriteri referuar dhe legjislacionit ne fuqi i sherben AK per te verifikuar permbushjen e specifikimeve teknike te mallrave te kerkuara duke u niur nga rendesia qe ato kane per shkak te funksionalitetit te tyre. AK ka keruar mostra vetem per 8 zera te cilat I konsideron te domosdoshme e vleresimin e tyre me qellim garantimin e cilesise se tyre.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet te deklarojë që merr përsipër transportin e mallrave prane Bashkise Devoll.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër te kryejne sherbimin e transportit ne adresen e percaktuar te Autoritetit Kontraktor. Kjo deklarate shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor per zbatimin me sukses te kontrates objekt prokurimi dhe se nuk do kete probleme gjate zbatimit të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike për mallrat janë hartuar nga Grupi i punës i caktuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor dhe janë vendosur në përputhje me LPP-në dhe në to përcaktohen qartë karakteristika e mallit objekt prokurimi duke mos përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Specifikimet teknike në rastin konkret janë vendosur për të përshkruar teresinë e elementeve më të rëndësishme të mallrave të cilat garantojnë AK për cilësinë e tyre. Specifikimet teknike janë vendosur duke pasur parasysh kërkesat e AK. Keto specifikime nuk përbëjnë pengesë për konkurrencën e hapur dhe pjesënarrjen e OE të cilët operojnë këto fushe.

SPECIFIKIMET TEKNIKE:

1. Lopatë universale me kokë çeliku të kalitur (trashësi > 1.5 mm) e trajtuar kundër ndryshkut, e lidhur fort me perçina me një bisht druri të fortë ose fiberglass (gjatësi 120-130 cm) ose ekuivalent
2. Kazmë universale dyanshme (me majë dhe teh) prej çeliku të rrahur dhe të kalitur me peshë koke > 1.5 kg, e montuar siguroreshëm me një bisht druri të fortë (ah ose frashër) ose fiberglass me gjatësi 90–100 cm, ose ekuivalent
3. Varre (çekiç i rëndë) me kokë prej çeliku të karbonizuar dhe të kalitur me peshë >3 kg e lidhur fort dhe me siguri me një bisht druri të fortë ose fiberglass me gjatësi 70 cm, ose ekuivalent
4. Prerëse shkurresh/ligustrash me bateri Li-Ion jo më pak se 36V, me bisht të gjatë (gjatësi totale e pajisjes jo më pak se 210 cm) dhe kokë prerëse me kënd të rregullueshëm nga -45

deri në +90 gradë, me gjatësi tehu jo më pak se 45 cm dhe distancë mes dhëmbëve jo më pak se 30 mm, ose ekuivalent.

5. Sopatë e madhe (për çarje dhe prerje drush) me kokë prej çeliku të kalitur me peshë jo më pak se 1.6 kg, e lidhur fort me një bisht druri të fortë ose material fiberglass me gjatësi jo më pak se 70 cm, ose ekuivalent
6. Kombinoshe pune (pantallona me kombrella/ripa) e prodhuar nga material rezistent dhe që merr frymë (përzierje pambuku dhe poliestre, jo më pak se 240 g/m²), me qepje të trefashta të përforcuara, me xhepa multifunksionalë (përfshirë xhepa për mbrojtëset e gjunjëve), pjesë elastike në bel për komoditet dhe elemente reflektuese për siguri në punë,
7. Kombinoshe pune (pantallona me kombrella/ripa) e prodhuar nga material rezistent dhe që merr frymë (përzierje pambuku dhe poliestre, jo më pak se 240 g/m²), me qepje të trefashta të përforcuara, me xhepa multifunksionalë, pjesë elastike në bel dhe elemente reflektuese; veshja duhet të jetë e personalizuar në pjesën e përparme (ose në shpinë) me logon e Bashkisë Devoll dhe tekstin "SHËRBIMET PUBLIKE BASHKIA DEVOLL" përmes stampimi ose qëndisje cilësore rezistente ndaj larjeve
8. Betonierë me motor me djegie të brendshme (benzinë) 4-kohësh me fuqi jo më pak se 4.0 HP (kuaj fuqi), me kapacitet kazani jo më pak se 180 litra, me kazan prej çeliku të përforcuar dhe kurorë gize rezistente, e montuar mbi shasi të fortë metalike me rrota të mëdha për transport të lehtë në terren
9. Karrocë dore pune (për ndërtim ose xhenio) me kapacitet jo më pak se 80 litra (ose jo më pak se 100 kg ngarkesë), me kazan prej fletë çeliku të zinguar me trashësi jo më pak se 0.8 mm, e montuar mbi shasi metalike të përforcuar me mbrojtëse për rrotën, e pajisur me një rrotë me gomë pneumatike (me dhomë ajri) me diametër jo më pak se 35 cm dhe doreza gome antirrëshqitëse
10. Sharrë me motor me djegie të brendshme (benzinë) 2-kohësh, me vëllim motori jo më pak se 50 cm³, fuqi motorike jo më pak se 2.8 kW (ose jo më pak se 3.8 PS) dhe peshë pa karburant/lamë jo më shumë se 5.3 kg; raporti fuqi-peshë duhet të jetë në kufijtë 1.8 - 2.0 kg/kW, niveli i presionit të zërit jo më shumë se 102 dB(A), niveli i fuqisë së zërit jo më shumë se 114 dB(A) dhe niveli i dridhjeve majtas/djathtas jo më shumë se 3.5 m/s²; e pajisur me lamë me gjatësi jo më pak se 40 cm, hap zinxhiri .325" dhe sistem efikas antidridhje e mbrojtjeje
11. Korrëse bari me rota, me motor me djegie të brendshme (benzinë) 4-kohësh me vëllim cilindrik (zhvendosje) jo më pak se 170 cm³ dhe fuqi nominale jo më pak se 2.6 kW (ose jo më pak se 3.5 PS) në një shpejtësi pune jo më pak se 2800 rpm. Pajisja duhet të ketë një gjerësi prerjeje jo më pak se 48 cm, sistem rregullimi të lartësisë së prerjes në kufijtë 25-85 mm, dhe kuti për mbledhjen e barit (kapëse) me kapacitet jo më pak se 70 litra. E përshtatshme për sipërfaqe lëndine deri në 2000 m², me peshë totale jo më shumë se 46 kg, nivel të garantuar të fuqisë së zërit jo më shumë se 96 dB(A) dhe vlerë vibrimi jo më shumë se 3.8 m/s²

12. Motokorrëse bari (me krah/shpinë) me motor me djegie të brendshme (benzinë) 2-kohësh, me vëllim cilindrik (zhvendosje) jo më pak se 41.5 cm³ dhe fuqi motorike jo më pak se 2.0 kW (ose jo më pak se 2.7 HP). Pajisja duhet të ketë një peshë pa karburant/element prerës jo më shumë se 8.0 kg, gjatësi të përgjithshme jo më pak se 180 cm dhe kapacitet të rezervuarit të karburantit jo më pak se 750 ml. Diametri i rrethit të prerjes duhet të jetë jo më pak se 520 mm. Pajisja duhet të jetë e pajisur me sistem antidridhje, dorezë universale me dy duar, dhe të ofrohet së bashku me kokën me fije mbrojtëse (filispanjë), thikën metalike me 3 tehe për shkurre (thikë furça), si dhe rripat e krahëve për mbajtje,
13. Fije plastike për prerje bari (për motokorrëse), me profil të rrumbullakët ose katror me trashësi/diametër jo më pak se 3.3 mm, e prodhuar nga material najloni i cilësisë së lartë, rezistent ndaj fërkimit dhe nxehtësisë. Sasia totale e kërkuar duhet të jetë jo më pak se 2000 metra (e ndarë në rrotulla/bobina standarde sipas paketimit të prodhuesit)
14. Set profesional çelësash dhe veglat dore për mekanikë/mirëmbajtje, i përbërë nga jo më pak se 85 pjesë. Veglat duhet të jenë të prodhuara nga çelik i aliazhuar me cilësi të lartë (Krom-Vanadium). Seti duhet të përfshijë domosdoshmërisht: set çelësash kombinim (jo më pak se 7 pjesë, në masat 10-18 mm), set kaçavidash profesionale dhe kaçavidë për fole bitash, dorezë krikët (ratchet) 1/2", set tubolarësh 1/4" dhe 1/2", set çelësash imbus (allen), si dhe një gamë të gjerë bitash (jo më pak se 40 pjesë) të llojeve Torx, Phillips, Pozidriv dhe Flat. Të gjitha veglat duhet të jenë të organizuara në një çantë transporti të përforcuar, me mbyllje të sigurt dhe me dizajnin e palosshëm që mundëson akses të shpejtë, ose ekuivalent.
15. Makinë mprehëse/prerëse këndore (fresibel i madh) profesionale, me fuqi nominale të motorit jo më pak se 2200 W. Pajisja duhet të jetë e projektuar për disqe me diametër jo më pak se 230 mm, me shpejtësi rrotullimi në zbrazëti jo më pak se 6500 rpm dhe filetë të boshtit M14. Duhet të jetë e pajisur me sistem mbrojtës ndaj rindezjes aksidentale (Restart Protection), sistem të nisjes së butë (Soft Start) për mbrojtjen e rrjetit elektrik, mbrojtëse disku të rregullueshme pa vegla dhe dorezë anësore ndihmëse antidridhje (Anti-Vibration) që mund të montohet në dy ose tre pozicione, ose ekuivalent
16. Makinë mprehëse/prerëse këndore (fresibel i vogël) me bateri, profesionale, e pajisur me motor pa (Brushless). Pajisja duhet të jetë e projektuar për disqe me diametër jo më pak se 125 mm, me filetë boshti M14 dhe shpejtësi rrotullimi në zbrazëti jo më pak se 8500 rpm. Duhet të ketë të integruara sisteme sigurie si: frena elektronike për ndalimin e shpejtë të diskut, mbrojtje nga mbingarkesa, mbrojtje nga kthesa e papritur (Kickback Control) dhe mbrojtje nga rindezja aksidentale. Pajisja duhet të ofrohet e kompletuar me: jo më pak se 2 (dy) bateri litiumi (Li-Ion) me tension jo më pak se 18V dhe kapacitet jo më pak se 4.0 Ah ose 5.0 Ah secila, si dhe karrikuesin e tyre të shpejtë, ose ekuivalent
17. Aparat saldimi elektrik i tipit Inverter (MMA) me elektrodë, kompakt dhe portativ, me teknologji të përparuar IGBT. Pajisja duhet të operojë me tension ushqyes njëfazor 230V / 50Hz, me rrymë saldimi të rregullueshme në kufijtë jo më pak se 10A deri në jo më pak

se 140A (ose 160A). Duhet të jetë e përshtatshme për përdorimin e elektrodave rutilike dhe bazike me diametër nga 1.6 mm deri në jo më pak se 3.2 mm. Aparati duhet të ketë të integruara funksionet automatike: Hot Start (për ndezje të lehtë të harkut), Arc Force (për stabilitet të harkut) dhe Anti-Sticking (kundër ngjitjes së elektrodës), si dhe sistem mbrojtjeje termostatike nga mbingarkesa me sinjalizim LED. Të ofrohet e kompletuar me kabllon e masës, kabllon me pincë për mbajtjen e elektrodës, maskë të thjeshtë saldimi dore dhe furçë/çekiç për zgjyrën

- 18.** Makinë shpuese/kaçavidë me bateri (trapan), profesionale, me funksion shpimi me goditje (Percussion/Hammer Drill) dhe e pajisur me motor pa (Brushless). Pajisja duhet të ketë një mandrinë metalike shtrënguese pa çelës (Keyless) me kapacitet kapjeje deri në jo më pak se 13 mm. Tensioni i punës duhet të jetë jo më pak se 18 V, me forcë shtrëngimi (Torque) jo më pak se 50 Nm, jo më pak se 2 shpejtësi mekanike të rregullueshme me rrotullime në zbrazëti deri në jo më pak se 1800 rpm dhe dritë LED të integruar për ndriçimin e zonës së punës. Pajisja duhet të ofrohet e kompletuar me: jo më pak se 2 (dy) bateri litiumi (Li-Ion) me kapacitet jo më pak se 4.0 Ah ose 5.0 Ah secila, karrikuesin e tyre të shpejtë dhe kuti transporti rezistente, ose ekuivalent
- 19.** Makinë profesionale për hapjen e kanaleve në mure (për instalime elektrike/hidraulike) të rënda, me fuqi nominale të motorit jo më pak se 2400 W (ose jo më pak se 3000 W). Pajisja duhet të funksionojë me sistem me disqe që punojnë paralelisht me diametër jo më pak se 150 mm (ose jo më pak se 180 mm). Duhet të ofrojë mundësinë e rregullimit të thellësisë së prerjes deri në jo më pak se 40 mm (ose 50 mm) dhe të gjerësisë së kanalit deri në jo më pak se 40 mm. Pajisja duhet të ketë të integruar sistemin për nisjen e butë të motorit (Soft Start) për mbrojtjen e rrjetit elektrik, mbrojtje nga mbingarkesa termike, si dhe adaptor të strukturuar për lidhjen me fshesë korrenti profesionale për thithjen efikase të pluhurit, ose ekuivalent
- 20.** Çekiç rotativ/kombinuar (matrapik i madh) profesional, i pajisur me dy funksione: shpim me goditje dhe vetëm goditje (për daltim/shembje). Fuqia nominale e motorit duhet të jetë jo më pak se 1500 W. Sistemi i kapjes së veglës duhet të jetë i tipit SDS-Max. Pajisja duhet të sigurojë një fuqi goditjeje për çdo fshirje jo më pak se 15 J (deri në 20 J) dhe të ketë një peshë neto në kufijtë 10 kg deri në 13 kg. Numri i rrotullimeve në minutë duhet të jetë i rregullueshëm (në kufijtë jo më pak se 100-300 rpm) dhe numri i goditjeve jo më pak se 2000 bpm. Duhet të ketë të integruar sistemin e mbrojtjes (friksionin e sigurisë) që ndalon rrotullimin në rast bllokimi të puntos, sistem antidridhje (Vibration Control) dhe tregues LED për konsumimin e karbonave. Të ofrohet i kompletuar me dorezë anësore ndihmëse, kuti transporti rezistente, jo më pak se 1 punto SDS-Max dhe 1 daltë, ose ekuivalent.
- 21.** Aparat elektrik profesional për ngjitjen me polifuzion (ngrohje) të tubave dhe rakordeve plastike (PPR, PE, PB). Pajisja duhet të ketë një fuqi nominale jo më pak se 800 W (ose deri në 1500 W) dhe të jetë e pajisur me termostat elektronik për rregullimin e saktë të temperaturës së punës në kufijtë 0–300°C. Duhet të ketë drita treguese LED për

gatishmërinë e temperaturës dhe mbështetëse (këmbëz) metalike për qëndrim të sigurt gjatë punës. Seti duhet të ofrohet i kompletuar brenda një kutie transporti metalike, duke përfshirë jo më pak se 4 (katër) matrica (koka ngjitëse) të veshura me material Teflon (PTFE) anti-ngjitës në përmasat: 20 mm, 25 mm, 32 mm dhe 40 mm, ose ekuivalent (Vidiator bulonash) profesional, i pajisur me motor pa (Brushless) për efikasitet të lartë dhe jetëgjatësi. Pajisja duhet të ketë kokë kapëse katrore me masë 1/2" (me unazë fiksuese). Tensioni i punës duhet të jetë jo më pak se 18 V, me forcë maksimale shtrëngimi/lirimi (Torque) jo më pak se 350 Nm (ose 400 Nm). Duhet të ofrojë rregullim elektronik të shpejtësisë dhe të forcës në disa nivele, me numër goditjesh në minutë jo më pak se 3000 bpm dhe dritë LED për ndriçimin e zonës së punës. Pajisja duhet të ofrohet e kompletuar: me jo më pak se 2 (dy) bateri litiumi (Li-Ion) me kapacitet jo më pak se 4.0 Ah ose 5.0 Ah secila, karrikuesin e tyre të shpejtë, një set bazë tubolarësh goditës (Impact Sockets) dhe kuti transporti rezistente, ose ekuivalent

22. Pincë universale (pincë e thjeshtë kombinimi) profesionale, me gjatësi totale jo më pak se 180 mm (ose 200 mm). Vegla duhet të jetë e prodhuar prej çeliku të aliazhuar me cilësi të lartë (Krom-Vanadium ose çelik i sepandur në vaj), me tehe prerëse të trajtuara termikisht (të kalitura me induksion) për prerjen e telave të butë dhe të fortë. Dorezat duhet të jenë ergonomike, të veshura me material plastik dy-komponentësh (anti-rrëshqitës), që ofrojnë kapje të sigurt dhe komoditet gjatë punës, ose ekuivalent
23. Pincë e rregullueshme për tuba (çelës papagall) profesionale, me gjatësi totale jo më pak se 250 mm. Vegla duhet të jetë e përbërë prej çeliku të aliazhuar me cilësi të lartë Krom-Vanadium (Cr-V), e trajtuar termikisht dhe me nofulla (dhëmbë) të kalitura me induksion për rezistencë maksimale ndaj konsumit. Duhet të ketë sistem rregullimi me mekanizëm të sigurt (me disa pozicione kyçjeje) që parandalon rrëshqitjen aksidentale gjatë shtrëngimit. Dorezat duhet të jenë të veshura me material plastik dy-komponentësh, ergonomik dhe anti-rrëshqitës për një kapje të sigurt, ose ekuivalent
24. Kaçavidë profesionale e kthyeshme me dy koka (dy-funksionale: me yll dhe e rrafshët), me gjatësi të shufrës jo më pak se 100 mm. Shifra duhet të jetë e prodhuar prej çeliku Krom-Vanadium (Cr-V), e trajtuar termikisht dhe me maja të magnetizuara (nga njëra anë me yll PH2 dhe nga ana tjetër e rrafshët SL6). Doreza duhet të jetë ergonomike, e veshur me material gome ose plastikë anti-rrëshqitëse, e projektuar për të lejuar heqjen dhe ndërrimin e shpejtë të shufrës sipas nevojës së punës, ose ekuivalent
25. Kokë universale metalike për makinë korrëse bari (koshare manuale), e prodhuar prej aliazhi alumini me cilësi të lartë dhe rezistencë të lartë ndaj goditjeve dhe konsumit. Koka duhet të jetë e tipit me montim të thjeshtë (me fije të para-prera) dhe e përshtatshme për fije najloni me trashësi të ndryshme (nga 2.0 mm deri në jo më pak se 3.0 mm). Duhet të ketë sistem universal fiksimi (me fileto standarde ose me rondelë shtrënguese) që përshtatet me pjesën më të madhe të koshaveve me benzinë në treg. Të ofrohet e kompletuar me rondelet e instalimit dhe një set fillestar fijesh korrëse, ose ekuivalent

✓ **Materialet e mesiperme të jenë me garanci 1 vit.**

- ✓ Te gjitha veglat e tjera te jene cilesore,profesionale per kryerjen sa me efektive te punes.
- ✓ Materialet te jene cilesore dhe te paisura me te gjitha aksesoret e nevojshem per funksionimin e tyre.

Njesia e Prokurimit: